REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1010/18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidemi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses .... me seli në .... kundër të padituri Q.A. , duke vendosur sipas padisë për rimbursimin e dëmit materil dhe jomaterial, pas mbajtjes se seancës kryesore dhe publike të datës, 27.08.2019, mori këtë:

A K T GJ Y K I M
Në bazë të pohimit

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses .... me seli në .... dhe **DETYROHET** i padituri Q.A. që paditëses tia rimbursoj shumën prej 120.00 €, përf dëmin e shkaktuar në aksiedntin e trafikut të ndodhur më dt.19.09.2015 në Gjjilan, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjyimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET i padituri që paditëses t'i paguaj shpenzimet gjyqësore në emër të tarifës gjyqësore në shumë prej 20 €.

A r s y e t i m i

Paditësja ka parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.22.11.2018, kundër të padituresë, për rimbrusimin e demit material dhe, jomaterila duke kërkuar që e padituratia rimbursojë shumën monetare prej 120 € për dëmin e shkaktuar në aksedent trafiku të ndodhur më dt.19.09.2015 në Gjilan. Gjilthashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimete e procedures.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.1010/2018 të dt.10 Janar 2019, të cilin i padituri e ka pranuar më dt. 14 janar 2019 (e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të padituri për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjti nëse nuk paraqet

përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

I padituri me parashtresën e dt.24,01.2019 ka paraqitur përgjigje në padi në të cilën në tërësi e pranon padinë dhe kërkesëpadinë duke theksuar se është i gatshëm të paguaj shumën prej 120 €.
Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të padituriut konstatoi se kerkesat janë të disponueshme për palët , prandaj në kuptim të nenit 148, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore – përcaktohet se '' në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep pa shqyrtim të mëtejm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesen apo gjithë kërkesëpadinë(aktgjykimi në bazë të pohimit)- vendosi pa shqyrtim të mëtejm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet tarifës për padi në shumë prej 20 € .

Andaj nga të lartcekurat, duke përfshirë dispozitat ligjore, gjendjen faktike dhe nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 e LPK-së gjykata vendosi si ne dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1010/18, datë 27 Gusht 2019

Gjyqtarja,
Mirvete Alidimi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-ës, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedures kontestimore apo nga shkaku se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.